



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2023:276563

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05642940

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania NTNP “ILVA” Sh.P.K., me seli në fshatin Buçe, Komuna e Dragashit, me NUI: 810291261A, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Asman Hoxha me seli të zyrës në Prizren, kundër debitorit “VALI” Sh.P.K., me seli në Suharekë, rruga “Brigada 123” me NUI: 811034636, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate Nadire Hoxha me seli të zyrës në Suharekë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.353/2023 të datës 13.11.2023, të Përmbaruesit Privat Mehdi Reshani, me seli në Prizren, jashtë seancës me datën 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “VALI” Sh.P.K., ANULOHET Urdhri Përmbarimor P.nr.353/2023 i datës 13.11.2023, i nxjerrë nga Përmbaruesi Privat Mehdi Reshani.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.353/2023 të datës 13.11.2023, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.12 të datës 27.06.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 2,190.00 Euro, me

kamatëvonesë 8 % vjetore nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, me arsyetimin se dokumenti në bazë të të cilit është dhënë udhri për përbarim është pa efekt juridik. Më tej ka theksuar se titulli përbarimor nuk është i përshtatshëm për përbarim, ku përpos tjerash duhet të përmbajë vëllimin, kohën e përmbushjes së detyrimit, si dhe fatura duhet të jetë e nënshkruar nga kreditori dhe debitori. Ka shtuar se me kreditorin duhet të bëhet barazimi real i faturave, pranimit të mallit, si dhe pagesa të bëhet në mënyrë vullnetare për borxhin e saktësuar dhe jo për obligime fiktive të pa pranuar. I ka propozuar gjykatës që propozimin për përbarim, me fatura jo reale dhe për një borxh që nuk ekziston në të vërtetë, të mos e pranojë dhe këtë çështje juridike ta kthejë si të pabazuar dhe të paargumentuar.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, me arsyetimin se propozimi për përbarim është i bazuar në faturën si dokument i besueshëm e cila i përmban elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 të LPP-së. Më tej ka theksuar se fatura e panënshkruar nuk mund të jetë shkak për anulimin e propozimit, pasi e njejta i është dërguar debitorit përmes e-mailit, të cilën debitori e pranon që e ka pranuar, kurse një nënshkrim i tillë nuk është paraparë me asnjë dispozitë të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, ndërsa të mbetet në fuqi urdhri P.nr.353/23 i datës 13.11.2023, si dhe të obligohet debitori që t'i paguajë të gjitha shpenzimet për avokatin sipas tarifës nr.9 të OAK-së dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përbarimor duhet të anulohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm” dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar“, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata gjeti se fatura nr.12 e datës 27.06.2023, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e as vulën e pranuesit– debitorit.

Duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar detyrimin që rrjedh nga fatura.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimi i faturës konkrete është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori, atëherë rezulton se fatura e lartcekur nuk mund të paraqes bazë për lejimin e përmbarimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2125/23, më datë 30.04.2024

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.